



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:112457

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06082835

C.nr.535/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.K me vendbanim në V. kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit (DKA në Vushtri), të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ardita Përçuku-Shyti, me objekt kontesti anulim konkursi, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 08.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K .
- II. ANULOHET KONKURSI nr. 58/23, i datës 20.01.2023, i rishpallur nga e paditura DKA në Vushtri, për pozitën me titull “Edukator/e për parashkollor për fëmijë 3-6 vjeç në Institucioni Parashkollor “Foleja”, në Vushtri.
- III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses A.K me të cilën ka kërkuar që të URDHËROHET e paditura DKA në Vushtri, që ta rishpallë konkursin për pozitën me titull “Edukator/e për parashkollor për fëmijë 3-6 vjeç në Institucioni Parashkollor “Foleja”, në Vushtri, nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të anuluar e deri në përmbushjen e detyrimit të përcaktuar me këtë aktgjykim.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 18.05.2023, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, me objekt kontesti anulim i konkursit nr. 58/23, i rishpallur nga e paditura DKA në Vushtri me datë 20.01.2023.

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes padisë dhe gjatë seancave ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj në tërësi si e bazuar dhe të anulohet konkursi i të paditurës nr. 58/23, i datës 20.01.2023, me arsyetimin se me këtë konkurs janë pranuar kandidatë të cilat kanë pasur kualifikim më të ulët akademik sesa ajo, konkretisht se janë pranuar kandidatë me drejtimin Pedagogji-tre (3) vjeçar, kurse ajo është me kualifikim adekuat, Fakulteti i Edukimit – katër (4) vjeçar. Ka theksuar se lidhur me këtë pozitë për të cilën është rishpallur konkursi (“Eduktor/e për parashkollor për fëmijë 3-6 vjeç në Institucioni Parashkollor “Foleja”, në Vushtrri), e paditura paraprakisht kishte shpallur një konkurs tjetër (nr. 1198/22, i datës 22.09.2022) dhe se ajo kishte marrë pjesë edhe në atë proces rekrutues por që kishte apstenuar në procedurën e intervistimit me arsyetimin se kur ka shkuar në objektin ku ka pasur të intervistohet, ka kuptuar se të gjithë kanë njohuri se kush do të pranohet në këto pozita. Ka shtuar se më pas ankesave dhe presionit të mediave, e paditura e ka anuluar atë konkurs dhe e ka rishpallur konkursin nr. 58/23, në të cilin sipas saj janë pranuar shumica e kandidatëve të pranuar edhe në konkursin e parë (të anuluar nga e paditura).

Në fjalën përfundimtare ka theksuar se ajo para se të hynte në testin me shkrim të konkursit të cilin ka kërkuar që të anulohet (nr. 58/23), e ka ditur që paraprakisht ishte shpërndarë testi me shkrim por nuk ka pasur mundësi që këtë ta dëshmonte, por që sipas saj kjo është vërtetuar me sqarimin që Zyra Kombëtare të Auditimit (ZKA), ka dhënë për gjykatën lidhur me gjetjet e këtij institucioni për këtë konkurs. Ka shtuar se mjafton që të shikohen përgjigjet e dhëna të kandidatës K.F, e cila është njëra nga kandidatet e përzgjedhura në këtë konkurs, për të konstatuar se pyetja 1 e deri në të 14, janë 99% të ngjashme me çelësin e përgjigjeve të përgatitur nga komisioni përzgjedhës i të paditurës. Ka theksuar po ashtu se pikërisht për të dëshmuar se konkursi ka qenë i parregullt (i kurdisur), e ka ushtruar edhe padinë, ndërsa nëse ky konkurs do të anulohet sipas saj kjo do të ndikonte që të ngrihej aktivizmi qytetar për të kërkuar drejtësi në gjykatë e po ashtu se do të ndikonte në institucionet shtetërore që të punonin më mirë dhe të zbatonin procedura meritore e jo diskriminuese nda qytetarëve.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar me padi por nuk i ka specifikuar.

E paditura, me përgjigje në padi dhe gjatë seancave e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke kërkuar që gjykata ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e saj. Ka shtuar se konkursi nr. 58/23, i datës 20.01.2023 ka qenë në harmoni me nenin 4, par 2, të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm për drejtimet e kërkuara për pozitën për të cilën është shpallur konkursi, kurse lidhur me pretendimet e paditëses se i janë dhënë përparësi kandidatëve me shkollim tre (3) vjeçar, me drejtimin pedagogji nga Fakulteti Filozofik dhe me shkollim privat e jo nga Fakulteti i Edukimit-Drejtimi Parashkollor katër (4) vjeçar, e paditura ka theksuar se Komisioni vlerësues i të paditurës ka zbatuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e UA-së 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, konkretisht nenit 2, par 3 dhe nenit 12 të tij, duke iu dhënë mundësi aplikimi të gjithë kandidatëve sipas kritereve të këtyre UA-ve. Po ashtu e paditura edhe rreth pretendimit të paditëses se për këtë konkurs Komisioni nuk ka nxjerrë vendim për listën përfundimtare por ka njoftuar kandidatët vetëm me njoftimin

nr. 17310/23, të datës 19.04.2023, një pretendim është i pabazuar sepse përpos njoftimit e paditura ka nxjerrë edhe vendimin 19159/2023, me të cilën ka publikuar listën definitive të kandidatëve të përzgjedhur.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e të paditurës ka deklaruar se e kundërshton në tërësi fjalën përfundimtare të paditëses se testi me shkrim ka qenë i shpërndarë para mbajtjes së tij për faktin se paditësja nuk ka arritur me asnjë provë që ta dëshmojë këtë e as faktin se kandidatja e përzgjedhur K.F e ka poseduar atë test paraprakisht, kurse rreth asaj se testi i kësaj kandidate ka qenë i panëshkruar, përfaqësuesja e të paditurës ka theksuar se kjo ka mund të ketë ndodhur për shkak të ngutisë ose se e njëjta ka harrur që ta nënshkruajë testin. Përfundimisht ka theksuar se pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave, është vërtetuar se e paditura procedurën rekrutuese të konkursit kontestues e ka zbatuar në harmoni dhe në afatin e kërkuar me legjislacionin në fuqi, me arsyetimin se gjatë këtij procesi gjyqësor nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e paditëses, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi konkursin nr. 58/23, i datës 20.01.2023.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova:

Dosja e konkursit nr.1198/2022, të datës 22.09.2022 (Në këtë dosje janë përfshirë këto akte: Vendimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, për themelimin e komisionit rekrutues të konkursit 1198/2022, me numër 1486/2022, datë 24.11.2022, Shpallja e konkursit 1198/2022, të datës 22.09.2022, i shpallur nga DKA- në Vushtri, Njoftimi i datës 14.11.2022 për listën e ngushtë të plotësimit të kriterëve të kandidatëve, Njoftimi nr. 61150/22, i datës 06.12.2022 për testin me shkrim, Njoftimi i datës 13.12.2022 për intervistën me gojë, Njoftimi për rezultatet përfundimtare, nr.63998/2022, datë 21.12.2022, Vendimi nr. 1350/23, i datës 27.12.2022 i Komisionit të Ankesave të DKA-së në Vushtri, për anulimin e konkursit 1198/2022, të datës 22.09.2022 si dhe Njoftimi për anulimin e konkursit 2093/23, të datës 12.01.2023).

Dosja e konkursit nr.58/23 të datës 20.01.2023, (Në këtë dosje janë përfshirë këto akte: Kërkesa nga drejtori i autorizuar I.J i të paditurës, e datës 13.01.2023, për shpalljen e vendeve të punës, Vendimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, për themelimin e komisionit rekrutues të konkursit 58/23, me numër 370/2023, datë 17.03.2023, Rishpallja e konkursit nr.58/23, i datës 20.01.2023, i shpallur nga DKA- në Vushtri, Njoftimi nr. 11725/23, i datës 10.03.2023 për listën e ngushtë të plotësimit të kriterëve të kandidatëve, Njoftimi nr. 13595/23, i datës 22.03.2023 për intervistën me shkrim, Njoftimi nr. 16027/23, i datës 07.04.2023 për intervistën me gojë, Njoftimi, i datës 07.04.2023, për korrigjimin e Njoftimit nr. 16027/23, i datës 07.04.2023 për intervistën me gojë si dhe Njoftimi për rezultatet përfundimtare, nr.17310/2023, datë 19.04.2023, lidhur me konkursin nr.58/23, i datës 20.01.2023).

Njoftimi për rezultatet e testit me shkrim, numër 15025/23, i datës 31.03.2023, Vendimi për zgjedhjen e aplikuesve, më numër 19159/23 datë 03.05.2023, Ankesa e paditëses e datës 25.04.2023, Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të DKA-së, nr. 19003/23, i datës 03.05.2023, si dhe Përgjigja me shkrim e Auditorës së Përgjithshme të ZKA-së, Vlora Spanca , me nr. 1135, e datës 15.07.2024, së bashku me testin me shkrim të kandidatës së përzgjedhur në këtë konkurs K.F dhe çelësit të përgjigjeve testit me shkrim të përgatitur nga komisioni rekrutues i konkursit nr.58/23 të datës 20.01.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, përgjigjes në padi si dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, duke çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja i ishte nënshtruar procedurave rekrutuese në konkursin nr. 1198/2022, të datës 22.09.2022 por që kishte apstenuar nga procesi i intervistimit. Po ashtu kontestuese nuk ishte as fakti se paditësja i ishte nënshtruar në tërësi procedurave rekrutuese të konkursit nr.58/23, i datës 20.01.2023, nga i cili proces, në rezultatet përfundimtare ishte në vendin e 17-të, nga 10 pozitat të cilat kanë pasur të pranohen. (Për këtë arsye gjykata nuk do të lëshohet as në elaborimin e provave/akteve që kanë të bëjnë me dosjet e këtyre konkurseve).

Kontestuese në mes palëve ishte nëse përzgjedhja e kandidatëve të konkursit nr.58/23, i datës 20.01.2023 ishte zhvilluar konform Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe UA-në nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Nga Ankesa e paditëses e datës 25.04.2023, është theksuar se e paditura ka shkelur nenin 4 par 2, të UA-së nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, për arsye se ajo ka poseduar kualifikimin e renditur si të parin me këtë dispozitë (Fakulteti i Edukimit-Drejtimi Parashkollor-katër vjeçar), duke iu dhënë përparësi kandidatëve me drejtimin Pedagogji-Fakulteti Filozofik-tre vjeçar, ndërsa me UA-në e lartcekur, kandidatët me këtë kualifikim do të mund të përzgjidhen vetëm në mungesë të kuadrove nga Fakulteti i Edukimit-Drejtimi Parashkollor-katër vjeçar.

Nga Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të DKA-së, nr. 19003/23, i datës 03.05.2023, është vërtetuar se ky organ i të paditurës ka refuzuar ankesën e paditëses me arsyetimin se me UA-në nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm e as me ndryshimin e tij me nr. 01/2022, nuk përcaktohet se një kualifikim arsimor ka përparësi ndaj një kualifikimi tjetër i paraparë në këtë UA.

Nga përgjigja me shkrim për gjykatën të Auditorës së Përgjithshme të ZKA-së V.S , me nr. 1135, e datës 15.07.2024, në të cilën përgjigje ishte bashkangjitur edhe testi me shkrim të kandidatës së përzgjedhur në këtë konkurs K.F si dhe çelësi i përgjigjeve të testit me shkrim të konkursit kontestues, është theksuar se gjetjet e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të

Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023, (faqe 21) kanë të bëjnë pikërisht me konkursin nr. 58/2023, të së paditurës, i cili është objekt i kësaj procedure kontestimore.

Pjesa aprovuese e kërkesëpadisë

Me nenin 1, të UA-së nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përcaktuar që “*Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i normativit për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, në edukimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë dhe konviktet e nxënësve*”, kurse me nenin 2 të tij është paraparë që kriteret për kuadrin profesional për mësimdhënësit e kopshteve të fëmijëve nga 3-6 vjet, të jenë “*2.1, Fakulteti i Edukimit-programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin parashkollor; 2.2, Shkolla e lartë pedagogjike-drejtimi për edukatorë, 2.3, Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme*” ndërsa me nenin 3, të UA-së nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e UA-së 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, është paraparë që nenit 12 të UA-së (05/2021), i shtohet paragrafi 6, me këtë përmbajtje “*Të gjithë kandidatët e kualifikuar në programin “përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve”, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, i plotësojnë kriteret për punësim në kopsht 3-6 vjeçar*”.

Në anën tjetër me nenin 2 par 4 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili ka qenë në fuqi në kohën e hapjes së konkursit kontestues (20.01.2023) ka qenë e përcaktuar se zyrtarët publik të fushës së arsimit konsiderohen nëpunës të shërbimit publik, ndërsa sipas nenit 6 par 1, të atij ligji ka qenë e paraparë që “*Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve*”, me paragrafin 2, të këtij neni është thënë se “*Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive*”, kurse me paragrafin 3, është përcaktuar se “*Procesi përzgjedhës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit*”.

Gjykata ka vendosur si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi ashtu që ka anuluar konkursin 58/23, të datës 20.01.2023, për arsye se gjatë shqyrtimit kryesor është provuar se procedura rekrutuese për përzgjedhjen e kandidatëve fitues të këtij konkursi nuk është zhvilluar sipas kriterëve ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën këtij procesi rekrutues për arsyet si më poshtë:

Pavarësisht se në hyrjen e vendimit të rishpalljes së konkursit nr. 58/23, të datës 20.01.2023, është theksuar se shpallja e konkursit është i bazuar edhe në Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, rezulton se me këtë proces rekrutimi e paditura nuk ka zbatuar parimet themelore të përzgjedhjes së kandidatëve në pozitën për të cilën është shpallur konkursi.

Pasi në [Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë](#) për vitin 2023, (faqe 21) është konstatuar se *“Për pozitën “Edukatore për Parashkollor”, testi me shkrim nuk ishte i nënshkruar nga kandidatja fituese. Gjithashtu përgjigjet e pyetjeve teorike të kandidates ishte identike me përgjigjet në shabllonin e testit me shkrim që kishte përgatitur komisioni për pranim dhe kjo lë të kuptojë që përgjigjet e testit me shkrim janë kopjuar”*, gjykata me kërkesën e datës 10.07.2024, ka kërkuar nga ZKA-ja sqarime nëse kjo gjetje ka të bëjë me konkursin nr. 58/2023, të datës 20.01.2023, që është objekt i kësaj çështje kontestimore dhe nga përgjigja me shkrim e Auditorës së Përgjithshme të ZKA-së V.S , me nr. 1135, e datës 15.07.2024, në të cilën përgjigje ishte bashkangjitur edhe testi me shkrim i kandidates së përzgjedhur në këtë konkurs K.F si dhe çelësi i përgjigjeve të testit me shkrim të konkursit kontestues, ishte sqaruar se kjo gjetje kishte të bënte pikërisht me konkursin nr. 58/2023 që është edhe objekt i kësaj procedure kontestimore.

Duke u bazuar në këto gjetje të raportit të auditimit të pasqyrave financiare të ZKA-së, për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023, përgjigjes së Auditorës së Përgjithshme për gjykatës e datës 15.07.2024 dhe analizimit të testit me shkrim të kandidates K.F e cila sipas Vendimit për Zgjedhjen e aplikuesve në listën definitive, më numër 19159/23, i datës 03.05.2023, ka qenë e renditur e 10-ta, duke e bërë atë njërin nga kandidatët e përzgjedhura të këtij procesi, e po ashtu pas analizimit edhe të çelësit të përgjigjeve të testit me shkrim të këtij konkursi të përgatitur nga komisioni rekrutues i të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se 14 nga 15 përgjigjet e testit me shkrim të kandidates K.F , kanë qenë identike me përgjigjet e sakta të çelësit të përgjigjeve të testit me shkrim, e përpos kësaj gjykata ka vërtetuar po ashtu se ky test me shkrim me emrin e kësaj candidate ka qenë edhe i panënshkruar.

Faktin se 14 nga 15 përgjigjet e testit me shkrim të kandidates K.F , janë identike gjykata e ka vërtetuar duke krahasuar edhe mënyrën e formulimeve të secilës nga pyetjet, ashtu që përpos asaj që pyetjet 1-8 kanë qenë me përgjigje opsionale, ngjashmëria totale në mes përgjigjeve të këtij testi dhe çelësit të përgjigjeve është identifikuar edhe tek pyetjet e hapura ku identifikohet se në fjalitë e përgjigjeve të dhëna, janë të ngjashme edhe shenjat e pikësimit (,) siç është rasti në pyetjet e 12 dhe 14.

Për më tepër, te pyetja e 12-të e cila ka qenë *“Çfarë kuptoni me termin Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme (SZhMFH)”* edhe pse sipas dokumentit të titulluar *“[Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet](#)”* të publikuar nga MASHT-i, është theksuar se *“Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme janë formulime që përshkruajnë pritshmëritë për sjelljen e fëmijëve dhe performancën apo arritshmërinë e tyre në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe të mësuarit, duke reflektuar në atë se “çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët”. Këto standarde kanë synim kryesor të stimulojnë zhvillimin optimal të fëmijëve pavarësisht gjinisë, karakteristikave individuale, shoqërore, nivelit ekonomik të familjeve të tyre, prirjeve apo nivelit të aftësive. Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, kanë në qendër fëmijën dhe janë hartuar për fëmijët, prandaj plotësimi i tyre duhet konsideruar vetëm si mbështetje për zhvillimin e fëmijëve”*, gjykata ka identifikuar se si në testin e kandidates K.F , ashtu edhe në çelësin e përgjigjeve të sakta të komisionit, është evidentuar përgjigja identike për këtë pyetje, me përmbajtjen

“Formulime që përshkruajnë pritshmeritë për sjelljen. SZHMFH janë formulime që përshkruajnë se çfarë duhet të dijnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët”.

Pra pavarësisht se me dokumentin e MASHT-it, që në mënyrë të zgjeruar përcaktohet se çfarë nënkuptohet me SZhMFH-në, gjykata ka vërtetuar se si në përgjigjen e çelësit të përgjigjeve të komisionit rekrutues e po ashtu edhe në testin me shkrim të kandidatës K.F , është përshkruar vetëm një përgjigje e shkurtër, e cila ka përmbledhur vetëm disa fjali nga ajo se çfarë ka përcaktuar dokumenti i MASHT-it për këtë çështje dhe se kjo përgjigje e shkurtër ishte tërësisht e ngjashme si në çelësin e përgjigjeve, ashtu edhe në testin e kandidatës.

Se testi me shkrim i kandidatës K.F , është i ngjashëm me çelësin e përgjigjeve të sakta evidentohet edhe te pyetja e 15 e testit me shkrim që ishte në formë të esesë, në të cilën kandidatët kanë pasur të shkruajnë për temën *“Gjithëpërfshirja në edukimin e fëmijërisë së hershme”*, me një minimum prej 150 fjalëve. Edhe në këtë pyetje, komisioni në çelësin e përgjigjeve ka përcaktuar fjalët kyçe që sipas komisionit rekrutues duhet të përmbajë eseu, në të cilat janë përfshirë fjalët *“edukatore mbështetëse, prindi, diversiteti, bashkëpunimi, stimulimi, planifikimi, konsultimi, përshtatja dhe vëzhgimi”*. Por, pavarësisht se me esë kandidatët mund të kenë formulime të ndryshme për një temë të caktuar, në rastin konkret rezulton se përpos pyetjeve 1-14 të cilat ishin identike me çelësin e përgjigjeve të sakta, edhe në esenë e testit me shkrim të kandidatës K.F , janë krijuar fjali apo janë përfshirë pikërisht shtatë (7) nga nëntë (9) fjalët të cilat komisioni i të paditurës i ka vlerësuar si kyçe, konkretisht në testin me shkrim të kësaj kandidate janë përdorur fjalët *“edukatore mbështetëse, diversiteti, prindërit, bashkëpunimi, planifikimi, përshtatja dhe vëzhgimi”*, që vërteton faktin se përgjigjet e testit me shkrim të kësaj kandidate është tërësisht i bazuar në çelësin e përgjigjeve të sakta.

Po ashtu përpos faktit se në mes testit me shkrim të kandidatës K.F dhe çelësit të përgjigjeve të testit me shkrim dallimet janë pothuajse minimale, një arsye tjetër i cili ndikon që testi me shkrim i kësaj kandidate të jetë i parregullt është edhe fakti se i njëjti nuk ka qenë i nënshkruar nga askush. Pra pavarësisht se në faqen e parë të këtij testi është dhënë vërejtja që *“Mos harroni ta nënshkruani testin në faqen e fundit”*, rezulton se për komisionin rekrutues mos nënshkrimi i testit të kësaj kandidate nuk është kondisuar si testim i parregullt dhe e njëjta ka kaluar në fazën tjetër të procesit rekrutues, e më pas edhe është zgjedhur si njëra nga 10 kandidatët fituese të këtij procesi.

Pretendimet e përfaqësues së të paditurës të dhëna në seancën e datës 08.08.2024 se ngjashmëria në mes testimit të kandidatës K.F dhe çelësit të përgjigjeve të testit me shkrim nuk përbënë fakt relevant se kjo kandidate ka kopjuar për shkak se e njëjta ka mund që të jetë përgatitur për testim ngase sipas saj pavarësisht se ka ngjashmëri në mes përgjigjeve, ka ndryshime në përpilimin e fjalive e po ashtu pretendimi se testimi i kësaj kandidate ka mbetur i panënshkruar ka mundur të ndodhë për shkak të ngutisë ose se ka mundur ta harroj për ta nënshkruar, për gjykatën janë pretendime tërësisht të pabazuara, të cilat mbështetën vetëm në hipoteza, ashtu që ngjashmërinë në mes testeve e ka kundërshtuar me arsyetimin se kandidatja K.F *“ka mundur të jetë e përgatitur”* apo arsyetimin se fakti se testi i kësaj kandidate ka mbetur i panënshkruar *“ka mundur të jetë për shkak të ngutisë apo se ka harruar”*.

Për gjykatën është e papranueshme që një obligim për nënshkrimin e testit me shkrim të përcaktuar nga vet komisioni vlerësues i të paditurës, i cili obligim nuk është përmbushur nga kandidatja K.F, mos të ndikoj fare që ai të testim të konsiderohet i parregullt fillimisht këtë nuk e ka bërë komisioni vlerësues i të paditurës e më pas edhe përfaqësuesja e të paditurës në këtë procedurë gjyqësore këtë fakt nuk e konsideron si parregullsi. Kjo ngase nënshkrimi i testimi bëhet me qëllim të identifikimit personal të kandidatit që i nënshtro, kurse nëse kjo tolerohet arsyetimi se “*ka mundur të jetë për shkak të ngutisë apo se ka harruar*” është juridikisht i pambshtetshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata ka vërtetuar faktin se testi me shkrim i njërit nga kandidatët fituese (K.F) të konkursit kontestues është identik me çelësin e përgjigjeve të sakta të këtij testi dhe se ky test ka qenë i panënshkruar, pra të njëjtit nuk i dihet autori dhe kjo është konsiderohet tërësisht e rregullt nga ana e të paditurës, gjykata nisur nga këto fakte, me dispozitivin I, të këtij aktgjykimi ka vendosur që ta anuloj konkursin kontestues sepse me përfshirjen e kësaj kandidate në listën e përzgjedhur janë shkelur parimet e pranimit të zyrtarëve publik të përcaktuar me nenin 6 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili ka qenë në fuqi në kohën e hapjes së konkursit kontestues, ku me paragrafin 1, të tij është përcaktuar që “*Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve*”, kritere këto të përcaktuara edhe me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, të në të cilat thuhet se “*2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive. 3. Procesi përzgjedhës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit*”, ngase me faktin se njëra nga kandidatët e përzgjedhura ka përgjigje identike me çelësin e përgjigjeve të atij testi, duke përfshirë edhe përdorimin e shumicën fjalëve kyçe (7 nga 9) edhe në eseun e shkruar, ka shkelur parimet e mundësive të barabarta në mes kandidatëve dhe meritës për tu pranuar në pozitën për të cilën ata kanë aplikuar.

Duke qenë se testi me shkrim i kandidates K.F ka qenë me përmbajtje pothuajse të njëjtë me çelësin e përgjigjeve të sakta, rezulton se edhe poentomi i testit të saj i cili ishte edhe i panënshkruar nuk është bërë duke u bazuar në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidates në fjalë dhe për shkak të këtyre shkeljeve është dëmtuar në tërësi integriteti i këtij procesi rekrutues (konkursi) dhe si i tillë i njëjti duhet të anulohet.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e paditëses se e paditura me këtë procedurë rekrutuese ka pranuar kandidate me drejtimin Pedagogji – tre vjeçar, të Fakultetit Filozofik, edhe pse ajo ka pasur përparësi sepse ka qenë e kualifikuar me drejtimin e Fakultetit të Edukimit-Programi katërvjeçar për edukimin parashkollor dhe kjo është bërë në kundërshtim me UA-në 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm sepse kualifikimi i saj është i

renditur i pari në nenin 4, par 2 të këtij UA-je, kurse kandidatët me kualifiime të tjera kanë mundur të pranohen vetëm në mungesë së drejtimin të saj, mirëpo për gjykatën ky pretendim i paditëses është i pabazuar sepse me UA-në e lartcekur, konkretisht nenin 4, par 2, nga pika 2.1-2.3 janë përcaktuar kualifikimet të cilat janë adekuate për të qenë mësime të grupit të fëmijëve 3-6 vjeç, mirëpo në një proces të barabartë rekrutimi të kandidatëve me këto kualifikime në të cilin i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës me gojë të gjithë kandidatët, nuk mund të interpretohet se kandidatët nga pika 2.1 e nenit 4, kanë përparësi në përzgjedhje para kandidatëve nga pika 2.2 (Shkolla e lartë pedagogjike-drejtimi për edukatorë) apo 2.3 (Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme). Mirëpo duhet ritheksuar se pavarësisht se ky pretendim i paditëses është i pabazuar, ashtu siç është theksuar më lartë, gjykata me dispozitivin I, të këtij aktgjykimi e ka vërtetuar si të bazuar pretendimin për parregullsi të këtij konkursi për shkak se nga ana e komisionit rekrutues është konsideruar i rregullt testimi me shkrim i kandidatës së përzgjedhur K.F .

Lidhur me pjesën refuzuese

Gjykata me dispozitivin II, të këtij aktgjykimi ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për pjesën me të cilën ajo ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën që ta rishpallë konkursin kontestues sepse kjo kërkesëpadi është e pabazuar nga fakti se për çështjen e shpalljes së konkurseve ashtu siç rregullohet me nenin 17 par 1, të Ligjit nr. 08/1-197 për Zyrat e Publik, që aktualisht është në fuqi, është përcaktuar që çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik, përgatit planin vjetor të personelit në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni ka paraparë që plani vjetor i personelit përmban nevojat për personel kompetent dhe cilësor në arritjen e misionit dhe objektivave të institucionit, prandaj gjykata nuk mundet që ta detyroj të paditurën që ta rishpallë konkursin me 10 pozita për pozitën me titull “Eduktor/e për parashkollor për fëmijë 3-6 vjeç në Institucioni Parashkollor “Foleja”, në Vushtrri” sepse kjo mund të bëhet varësisht nga nevojat e të paditurës për këto pozita.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së e po sipas të cilit përcaktohet që “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, për faktin se paditësja pavarësisht se e ka fituar pjesërisht kontestin, nuk ka krijuar asnjë shpenzim procedural.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:112457, C.nr.535/2023, me datë 23.08.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.